

Nr. Prot _____ Datë ____/____/2019

Nr. Prot _____ Datë ____/____/2019

KONTRATË PËR SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT TE GAZIT NATYROR NDËRMJET SHOQËRIVE ALBPETROL SH.A. DHE ALBGAS SH.A

E lidhur sot me datë ____/____/2019, ndërmjet:

- 1. Shoqërisë ALBPETROL Sh.a.**, me seli në adresën “Rruga Nacionale Fier - Patos”, km 7, Fier, me nr. NIPT **J82916500U**, e përfaqësuar nga Z. Kastriot Bejtaj , në cilësinë e **Administratorit** të shoqërisë **Albpetro Sh.a.**, këtu e më poshtë do të quhet **“Prodhuesi”**,

dhe
- 2. Shoqërisë ALBGAS Sh.a.**, me seli, rruga e “Kosovarëve”, pallati “Ndër Pro” Sh.p.k, Njësia Administrative nr. 5, Tirane, me nr. NIPT **L71306034U**, përfaqësuar nga Z. Arber Avrami, në cilësinë e **Administratorit** të shoqërisë **Albgaz Sh.a.**, këtu e më poshtë do të quhet **“Operatori”**, bashkarisht referuar si **“Palët”**.

Meqënëse:

- (A)** Shoqëria Albpetro Sh.a, në cilësinë e prodhuesit, është një shoqëri tregtare që zotëron të drejta kërkimi, prodhimi dhe tregtimi të hidrokarbureve (përfshirë dhe gazin natyror) në Shqipëri.
- (B)** Shoqëria Albgaz Sh.a, në cilësinë e Transmetuesit funksionon si operator i kombinuar i gazit natyror dhe është certifikuar me vendim nr. 179, datë 08.11.2017 dhe licensuar si i tillë me vendim nr. 188, date 10.11.2017 nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Atëherë, palët bien dakord të lidhin këtë Kontratë me termat dhe kushtet e mëposhtme:

Neni 1 Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë te Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9901, datë 01.04.2008 *"Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"*, të ndryshuar, ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 *"Për Ndërmarrjet Shtetërore"*, të ndryshuar, ligjit nr.102/2015, *"Për Sektorin e Gazit Natyror"*, ligjit nr. 8450, dt.24.02.1999, *"Për perpunimin, transportin dhe tregtimin e naftes dhe gazit dhe të nenprodukteve të tyre"*, të ndryshuar, Vendimin nr.848, datë 07.12.2016, *"Për krijimin e Shoqërisë "Albgaz" Sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive "Albpetro" Sh.a. dhe "Albgaz" Sh.a."*, të ndryshuar, ku Këshilli i Ministrave ka miratuar krijimin e autoritetit publik që është përgjegjës për trasmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, Vendimin nr.97 datë 23.04.2018 të E.R.E. *"Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të Gazit Natyror nga Shoqëria Albgaz Sh.a., për vitin 2018"*, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 2 **Përkufizime dhe interpretime**

2.1 Përkufizime:

Në këtë Kontratë, duke përfshirë edhe Anekset, me perjashtim të rastit kur konteksti e kërkon ndryshe termat e përdorur në të dhe anekset e saj do të kenë të njëjtin kuptim me përkufizimet e Ligjit nr. 102/2015, “Per Sektorin e Gazit Natyror” si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

2.2 Interpretime:

- 2.2.1 Fjalët që tregojnë njëjesin do të përfshijnë shumësin dhe anasjelltas;
- 2.2.2 Të gjitha afatet e cituara në këtë kontratë janë kalendarike;
- 2.2.3 Titujt e neneve nuk do të ndikojnë në interpretimin e përmbajtjes së tyre;
- 2.2.4 Referenca në “ligj” do të përfshijë gjithë amendamentet, modifikimet ose ligjet zëvendësuese, të bëra para apo pas datës së kësaj Kontrate dhe gjithë aktet nënligjore të dala në zbatim janë në përputhje me një ligj të tillë;
- 2.2.5 Referencat për një Palë është një referencë për një Palë të kësaj Kontrate;
- 2.2.6 Referencat për Nenet dhe Anekset janë referenca në Nenet dhe Anekset e kesaj Kontrate; përveç kur në mënyrë specifike shprehet ndryshe;
- 2.2.7 Çdo kusht ose formulim i Kontratës, që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndveshtrimin e qëllimit për të cilin është lidhur kjo kontratë nga palët,
- 2.2.8 Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë kontratë, aplikohen parashikimet e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe si dhe ato të parashikuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit të miratuar nga ERE.

Neni 3 **Qëllimi i kontratës**

Objekti i kësaj kontrate është transmetimi i gazit natyror nga Shoqëria Albgaz Sh.a., përkundrejt një tarife transmetimi, për llogari të Shoqërisë Albpetrol Sh.a. Shoqëria Albpetrol Sh.a. kryen aktivitetin e prodhimit dhe shitjes së gazit natyror, ndërsa Shoqëria Albgaz Sh.a. realizon transmetimin e gazit natyror me anë të linjave të veta. Kjo Kontratë rregullon çmimin, kushtet dhe afatet për realizimin e këtij bashkëpunimi midis prodhuesit dhe Operatorit.

Kjo Kontrate rregullon të gjithë marrëdhënien e shërbimit të transmetimit të gazit natyror ndërmjet Palëve duke përfshirë, por jo duke u kufizuar, edhe programimin, nominimin, lëvrimin dhe pranimin e gazit natyror për periudhën kohore **01.01.2019 - 31.12.2019**.

Neni 4 Afati i kontratës

Kjo kontratë lidhet për një afat 1 (një) vjeçar, duke filluar nga data 01.01.2019, që është dhe data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate (data efektive). Kjo kontratë mund të zgjidhet përpara afatit me një njoftim paraprak me shkrim nga secila pale 2 (dy) muaj përpara datës së përfundimit të afatit të saj, si dhe në çdo rast tjetër që parashikohet në këtë Kontratë.

Neni 5 Tarifa e Shërbimit

- 5.1 Për transmetimin e gazit natyror tarifa do të jetë 28 (njëzet e tetë) lekë/m³ pa TVSH në bazë të Vendimit të ERE-s nr.97 datë 23.04.2018, që është lënë në fuqi me Vendimin e ERE-s nr.269 datë 21.12.2018.
- 5.2 Tarifa e mësipërme do të jetë e pandryshueshme me përjashtim kur ndryshimi i saj bëhet me vendim të ERE-s.

Neni 6 Faturimi dhe mënyra e pagesës

- 6.1 Operatori do të dergojë faturën tatimore të shërbimit tek adresa e Prodhuesit Brenda 5 (pese) ditëve nga data e leximit përfundimtar mujor. Fatura tatimore duhet të përmbajë: tarifën mujore të muajit për të cilën lëshohet; mënyrën e përlllogaritjes së tarifës duke përcaktuar sasinë e gazit të transmetuar dhe tarifën e aplikuar si dhe çdo element tjetër në përputhje me ligjin nr.92/2014 “*Per tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*” të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Bashkëngjitur faturës mujore duhet të jenë procesverbalet e mbajtura nga palët për leximin e sistemeve përkatëse të matjes mbi bazën e të cilave është përlllogaritur sasia e gazit natyror.
- 6.2 Diferenca e krijuar sipas pikës 10.5 të nenit 10 do të zbritet nga fatura e shërbimit të transmetimit që përpilohet nga Operatori.
- 6.3 Prodhuesi do të kryejë pagesën në llogarinë bankare të Operatorit Albgaz Sh.a, sipas vlerës përkatëse të faturës në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.
- 6.4 Për çdo ditë vonesë Prodhuesi duhet t’i paguajë Operatorit kamatvonesë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*”, i ndryshuar.

Llogaria bankare e Operatorit është: AL65212210390000000000884510.

Llogaria bankare e prodhuesit është: _____

Neni 7

Pikat e Lëvrimin të Gazit Natyror nga Operatori

- 7.1 Sasia e gazit shoqërues ose natyror do të lëvrohet nga Prodhuesi (Q.P.N Fier) tek Operatori në pikat e lëvrimin në vendburimet prodhuese referuar infrastrukturës aktuale te Transmetim të gazit, si më poshte:
1. Cakran, Poligoni i matjes së gazit në Stacionin e Kompresorëve Drenovë
- 7.2 Sasia e gazit, pas transmetimit, do të lëvrohet nga Operatori tek Prodhuesi (Q.A.SH.N.G Patos) në pikat e lëvrimin si më poshte:
1. Poligoni i matjes pranë furrave për Dekantimin Kash.
 2. Poligoni i matjes pranë furrave për Dekantimin Visokë
 3. Stacioni i gazit Ballsh për Dekantimin Konsumatorët Privat- Ballsh.
 4. Stacionin i gazit Fier, për Konsumatorët Privat-Fier

Neni 8

Sasia, Presioni i Lëvrimin dhe Cilësia

- 8.1 Sasia e gazit natyror e cila lëvrohet nga Prodhuesi tek Operatori është sasia e matur nga pajisjet matëse të instaluar në pikën me të afërt teknike të lëvrimin të gazit natyror (grykë të pusit).
- 8.2 Sasitë e gazit natyror do të lëvrohen nga Prodhuesi tek Operatori në pikën e lëvrimin, sipas standarteve teknike si më poshtë:
1. Për Cakran, presioni $P_{\min} = 1$ (një) bar; $P_{\max} = 15$ (pesëmbëdhjetë)

Neni 9

Matja

- 9.1 Sistemi i matjes në pikat e lëvrimin do të instalohet nga Prodhuesi ndërsa sistemi i matjes në pikat e lëvrimin sipas nenit 7.2 do të instalohet nga Operatori, dhe do të bashkëvulosen nga të dyja palët gjatë fazës së instalimit.
- 9.2 Sistemi i matjes i cili do të instalohet në pikat e lëvrimin duhet të jetë sipas standarteve teknike të aprovuar dhe të kalibruar nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjisë.
- 9.3 Nëse Operatori ose prodhuesi dëshirojnë të inspektojnë, testojnë ose kalibrojnë pajisjet matëse, ata duhet tja kërkojnë këtë palës tjetër nëpërmjet një njoftimi me shkrim, për të kryer një inspektim të përbashkët, testim apo kalibrim të pajisjeve matëse të instaluar në pikat e lëvrimin.
- 9.4 Nëse raportet e testimit ose kalibrimit tregojnë gabime në matje për pajisjet matëse, atehere leximi aktual i matjeve i regjistruar gjatë periudhës së testimit apo kalibrimit do të korrigjohet, duke e ulur ose rritur, sipas rastit, në masën e shkallës së gabimit në matje të treguar në raportin e testimit apo kalibrimit të dakortësuar nga të dy palët.
- 9.5 Operatori është i detyruar t'i mundësojnë pa pagesë në çdo kohë Prodhuesit leximin e aparateve matëse të gazit. Instalimi, mirëmbajtja dhe verifikimi i saktësisë

- së matësit bëhen nga Operatori me shpenzimet e tij. Matësit e gazit duhet të jenë në përputhje me legjislacionin për instrumentet matëse.
- 9.6 Te gjitha pajisjet matëse të përdorura për të nxjerrë të dhëna mbi sasinë e gazit për përlllogaritjet e faturës në përputhje me këtë kontratë do të vulosen nga të dyja palët dhe vulat nuk do të thyhen me përjashtim kur palët bashkarisht bien dakort për këtë proces si pasojë e një nevoje për të testuar pajisjet matëse ose kur palët kanë dyshime mbi saktësinë e matjes.

Neni 10 Leximi dhe Faturimi

- 10.1 Secila nga Palët ka të drejtë në çdo kohë të kryejë leximin e sistemit të matjes në pikat e levrimit duke njoftuar Palën tjetër të paktën 3 ditë përpara, për ditën, orën dhe përfaqesuesit e saj në mënyrë që të bëhet leximi në praninë e përfaqësuesve të secilës Palë.
- 10.2 Të dhënat e sistemit të matjes do të pasqyrohen në një procesverbal të nënshkruar nga përfaqesuesit e të dyja palëve.
- 10.3 Nëse njëra nga Palët mungon gjatë leximit të përbashkët, pala tjetër mund të regjistrojë leximin e matësit dhe t'i njoftojë palës në mungesë, brenda orës 12.00 të ditës pasardhëse, leximin e regjistruar.
- 10.4 Leximi që do të konsiderohet për efekt të faturimit do të jetë leximi i realizuar në ditën e fundit të muajit.
- 10.5 Nëse do të konstatohet diferencë midis sasisë së lëvruar sipas pikës 7.1 të nenit 7 dhe sasisë së transmetuar sipas pikës 7.2 të nenit 7, kjo diferencë do të merret përsipër nga Operatori.

Neni 11 Periudha tranzitore

Palët bien dakort që deri në instalimin e sistemit të matjes ekziston një periudhë tranzitore e cila e bën të pamundur zbatimin e Nenit 9 dhe 10 të kësaj kontrate. Për pasojë gjatë periudhës tranzitore do të merret e mirëqene dhe e dakortësuar se:

- a) Sasia e lëvruar nga Prodhuesi tek Operatori do të konsiderohet sasia mujore e prodhuar nga vendburimi.
- b) Sasia që do të faturohet Prodhuesit nga Operatori gjatë fazës tranzitore është sasia e matur në pikat e levrimit të gazit nga Operatori sipas nenit 7.2 here/shumëzuar çmimin e transmetimit.

Neni 12 Planifikim dhe Ndërprerja e Lëvrimit

- 12.1 Prodhuesi duhet të dorëzojë Operatorit, sipas parashikimeve të tij, një plan lëvrimit duke specifikuar sasinë e gazit natyror që planifikon të lëvrojë për muajin kalendarik pasardhës, sipas pikave të levrimit, Afati për dorëzimin e parashikimit nga prodhuesi tek Operatori nuk duhet të jetë më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e përfundimit të muajit.

- 12.2 Palët bien dakort se duhet të takohen në mënyrë periodike, sipas nevojave, për të përcaktuar dhe rregulluar sasi të gazit natyror të planifikuar paraprakisht nga Prodhuesi.
- 12.3 Transmetimi i gazit Natyror objekt i kësaj kontrate, do të ndërpritet nëse është e nevojshme, dhe në masën që i duhet paleve për të qënë në përputhje me rregullat teknike të mirëmbajtjes gjithmonë nëpërmjet një njoftimi paraprak dhe palës tjetër.
- 12.4 Sasia e parashikuar për tu lëvruar nga “Prodhuesi” Shoqëria Albpetro sh.a, që do të transmetohet nga “Operatori” shoqëria Albgaz” Sh.a, është 770.000(*shtatëqind e shtatëdhjetë mijë*)Nm³ ne muaj, për periudhën **01.01.2019-31.12.2019**

Neni 13 Afatet e Njoftimit

- 13.1 Operatori duhet të njoftojë prodhuesin brenda afatit të parashikuar, për ngjarjet e mëposhtme:
- a) Për planin e remonteve, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas aprovimit të tij nga Administratori i Shoqërisë ose personat e autorizuar prej tij
 - b) Për ndërprerjet e planifikuara për remonte, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data e ndërhyrjes
 - c) Për ndërprerjet e paplanifikuara, menjëherë sapo të vihet në dijeni nga dispeceria.
 - d) Për ngjarjet e forcës madhore duhet të njoftohet menjëherë nga data e ngjarjes.
- 13.2 Operatori për të gjitha rastet e parashikuara në Nenin 13.1 duhet të njoftojë prodhuesin për parashikimin e përafërt të kohës së ndërprerjes dhe kohës së riparimit.
- 13.3 Të gjitha njoftimet sipas këtij neni si dhe çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i lejuar nga kjo Kontratë është i vlefshëm nëse bëhet me shkrim dhe mund të dorëzohet ose të dërgohet me postë në adresën e mëposhtme ose në një tjetër adresë që mund t'i njoftohet nga çdo Palë Palës tjetër në pajtim me këtë Nen. Njoftimi do të ketë efekt pas marrjes së tij nga pala tjetër. Adresat përkatëse të palëve për mbajtjen e korrespondencës janë të përcaktuara më poshtë:

Për Prodhuesin :

Rruga Nationale Patos-Fier, km 7 ose Sky Tower, Kati 7, nr.21, Tiranë
Në vëmendje të Z.Kastriot Bejtaj

Për Operatorin:

Rruga e “Kosovarëve”, pallati “Ndër Pro” Sh.p.k, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë
Në vëmendje të Z.Arber Avrami

Neni 14

Përgjegjësia për dëmet

- 14.1 Secila nga Palët duhet të sillet me mirëbesim dhe të tregojë kujdes në kryerjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate. Secila Palë është përgjegjëse për çdo humbje apo dëm të shkaktuar Pales tjetër të cila janë rezultat i drejtperdrejte i veprimeve ose mosveprimeve të kësaj pale dhe duhet ta dëmshpërblejë këtë të fundit. Në rast se Palet nuk bien dakord për masën e dëmshpërblimit, do ti drejtohen gjykatës kompetente në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në kohën e lindjes së këtij konflikti.
- 14.2 Operatori është përgjegjës për çdo çlirim të gazit gjatë procesit të transmetimit të tij.

Neni 15

Forcat madhore

- 15.1 Asnjëra nga palët nuk do të jetë përgjegjëse kundrejt palës tjetër për moszbatimin e detyrimeve të saj sipas Kontratës si rezultat i Forcës Madhore.
- 15.2 Përkufizimi "Force madhore" do të thotë një ngjarje e cila nuk ka ardhur si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve ose nga neglizhenca e një Palë, është një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të një Palë e cila vepron në përputhje me standartet e një Prodhuesi ose Operatori të kujdesshëm dhe të arsyeshëm. dhe që e bën përkohësisht ose përgjithmonë të pamundur për këtë palë të permbush ndonjë nga detyrimet e kësaj Kontrate. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara si lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrengime të karantinës dhe embargo tranziti. Për efekt të kësaj Kontrate rast i Forcës Madhore do të jetë edhe ndalimi i prodhimit në vendburimet e Prodhuesit.
- 15.3 Pala e cila pretendon se ndodhet përpara një ngjarje të Forcës Madhore duhet të:
- 15.3.1 Të njoftojë menjëherë Palën tjetër për ngjarjen e ndodhur, dhe duhet ti vendos në dispozicion të gjithë informacionin mbi shkaqet e saj. Ky njoftim duhet të bëhet menjëherë nga dita që ka ndodhur kjo ngjarje; dhe
- 15.3.2 Të marri të gjitha masat e arsyeshme për të rregulluar situatën si dhe të ndermarri masat e duhura për të minimizuar efektet e kësaj ngjarjeje. Për çdo rast Pala që pretendon se ndodhet përpara një rasti të forcës Madhore duhet ta informoj në mënyrë periodike Palën tjetër lidhur me të gjitha hapat e ndërmarra.
- 15.4 Në rast se ekzekutimi i kontratës bëhet i pamundur për shkak të një ngjarje të Forcës Madhore, dhe palët bien dakord se ndodhen përpara një ngjarje të tillë, detyrimet e palëve mund të pezullohen për sa kohë zgjat kjo ngjarje por Kontrata do të vazhdoj të jetë në fuqi.
- 15.5 Pavarësisht sa më sipër, nëse një ngjarje ose rrethane e Forcës Madhore ndodh dhe ka

zgjat për një periudhë përtej 30 (tridhjetë) ditëve, Palët do të takohen të diskutojnë pasojat dhe planin e veprimeve që duhen ndërmarrë për të zbutur efektet ose për t'u përshtatur me rrethanat.

- 15.6 Në rast se ngjarja e Forcës Madhore vazhdon për një periudhë prej më shumë se gjashtë (6) muajsh, secila nga Palët ka të drejtë që me dhënien e një njoftimi paraprak me shkrim prej tridhjetë (30) ditësh që Pala tjetër të perfundojë këtë Kontratë pa asnjë detyrim, por gjithsesi ky përfundim nuk shkarkon palët nga ndonjë angazhim apo detyrim i papërbushur apo i pezulluar, që duhej realizuar përpara ngjarjes së Forcës Madhore.

Neni 16 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje ose ankim që lind nga rregullimi, interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Kontrate dhe/ose që ka lidhje me të, do të zgjidhet me bisedime midis palëve ose nga ERE. Në rast të kundërt secila nga palët ka të drejtë t'i drejtohet për shqyrtim Gjykatës kompetente Shqiptare.

Neni 17 **Të ndryshme**

- 17.1 Të gjitha kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate konsiderohen thelbësore dhe mund të shtohen dhe/ose ndryshohen vetëm nëse vullneti i të dy paleve është shprehur paraprakisht me shkrim dhe të miratuar nga Bordi i ERE-s.
- 17.2 Kjo Kontratë përben marrëveshjen e vetme dhe të plote midis palëve, në lidhje me ofrimin e shërbimit të përcaktuar në objektin e saj, dhe zëvendëson çdo marrëveshje verbale ose të shkruar të mëparshme ndërmjet palëve
- 17.3 Në rast se ndonjë nen i kësaj Kontratë është ose bëhet pjesërisht ose plotësisht i pavlefshëm, antiligjor ose i pazbatueshëm, palët bien dakord që ta heqin këtë nen dhe kur është mundësia ta zëvendësojnë atë me një nen tjetër të vlefshëm dhe Kontrata do të vazhdojë të ketë efekte ligjore
- 17.4 Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë do jenë të zbatueshme edhe në rastet kur Prodhuesi në cilësinë e përdoruesit fundor të gazit, ja kalon këtë funksion palëve të treta.
- 17.5 Zgjidhja e kësaj Kontrate nuk do t'i lehtësojë Palët nga detyrimet që kanë përkundrejt njëra - tjetrës deri në datën e zgjidhjes ose nga detyrimet të cilat lindin nga veprimet e kryera përpara kësaj date.
- 17.6 Kontrata do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Neni 18
Njoftimet

- 18.1 Të gjitha afatet e cituara në këtë kontratë janë kalendarike.
Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën zyrtare të palës tjetër. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet zyrtarisht te palët.
- 18.2 Zbatimi i kësaj kontrate do të ndiqet në vijimësi nga ana e Albgaz Sh.a nga Drejtori i Drejtorisë Teknike dhe Drejtori i Drejtorisë Tregtare dhe Rregullatore.
Zbatimi i kësaj kontrate do të ndiqet në vijimësi nga ana e Albpetrol nga Drejtori i Shitjes, Drejtori i prodhimit dhe .

Kontrata hartohet në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) kopje për secilën palë. Kontrata e mësipërme, pasi u lexua, u kuptua, firmoset me vullnetin e lirë të palëve.

PALËT

ALBGAZ Sh.a.
ADMINISTRATORI

Z. Arber AVRAMI

ALBPETROL Sh.a.
ADMINISTRATORI

Z. Kastriot BEJTAJ